



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 4 dhjetor 2017
Nr. ref.: RK 1166/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI14/17

Parashtrues

Shaban Syla

Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, PN. nr. 298/2016,
të 25 majit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Shaban Syla nga Kishnareka (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), aktualisht duke vuajtur dënimin me burg në Qendrën Korrektuese në Dubravë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, PN. nr. 298/2016, të 25 majit 2016, me të cilin ishte refuzuar si e pabazuar ankesa e parashtruesit të kërkesës për përfshirjen e kohës së arrestit të tij shtëpiak në llogaritjen e dënimit me burg.
3. Aktvendimi i lartcekur i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 7 qershor 2016.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit, i cili pretendohet se ka shkelur dispozitat e kodit të procedurës penale dhe të kodit penal dhe ka vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë gjendjen faktike; parashtruesi i kërkesës nuk i është referuar asnjë dispozite kushtetuese.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullit 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 9 shkurt 2017, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 20 mars 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Gresa Caka-Nimani.
8. Më 2 maj 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të plotësojë formularin e kërkesës dhe t'i bashkëngjisë të gjitha dokumentet relevante.
9. Më 30 maj 2017, Gjykata ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke kërkuar që të dorëzojë dëftesën e pranimit të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit nga ana e parashtruesit të kërkesës.
10. Më 17 maj 2017, parashtruesi e dorëzoi formularin e plotësuar të kërkesës.
11. Më 6 qershor 2017, Gjykata ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit.
12. Më 30 qershor 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi dëftesën e kërkuar për pranim nga parashtruesi i kërkesës.

13. Më 24 tetor 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 17 dhjetor 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktgjykimi P. nr. 592/11) e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë në tentativë dhe e dënoi atë me burgim. Ky aktgjykim u vërtetua nga Gjykata e Apelit (Aktgjykimi PAKR. nr. 102/13, i 12 dhjetorit 2013).
15. Pas këtij aktgjykimi, parashtruesi i kërkesës vazhdoi procedurën lidhur me llogaritjen e kohës së kaluar në arrest shtëpiak në dënimin me burgim ndaj tij.
16. Në të vërtetë, më 29 mars 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë (P. nr. 592/2011) vendosi ta përfshijë kohën e arrestit shtëpiak të parashtruesit të kërkesës në periudhën e dënimit të tij me burgim.
17. Parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë ndaj këtij vendimi në Gjykatën e Apelit *“për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe aplikimit të gabuar të dispozitave ligjore, vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes së fakteve dhe shkeljes së Kodit Penal”*.
18. Më 25 maj 2016, Gjykata e Apelit (Aktvendimi PN. nr. 298/2016) refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin (P. nr. 592/2011) të Gjykatës Themelore.
19. Gjykata e Apelit konkludoi se *“pretendimet e ankimuarra më sipër janë të pabazuara dhe gjykata e shkallës së parë ka llogaritur saktë masën e arrestit shtëpiak në dënimin e shqiptuar kundër të dënuarit Shaban Sylja, në bazë të Aktgjykimit P. nr. 592/11, të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të 17 dhjetorit 2012, i cili bëhet përfundimtar më 12 dhjetor 2013”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ai *“ishte në arrest shtëpiak nga 28 korriku 2011 deri më 23 mars 2015”*, pa ia njohur gjykatat *“arrestin shtëpiak me orë dhe ditë”*.
21. Parashtruesi i kërkesës deklaroi se ai ka paraqitur kërkesën e tij për shkak të *“dispozitave të procedurës penale dhe aplikimit të gabuar të dispozitave ligjore, vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes së fakteve dhe shkeljes së Kodit Penal”*.
22. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që t'i *“njihet [atij] arresti shtëpiak dhe me orë dhe ditë ashtu siç e kam mbajtur me përpikshmëri”*.
23. Në fund, parashtruesi i kërkesës deklaroi: [Unë] *“nuk kërkoj as më shumë as më pak vetëm atë që ma njeh Kushtetuta e Republikës së Kosovës”*.

Pranueshmëria e kërkesës

24. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të parapara më tej në Ligj dhe të parashikuara në Rregullore të punës.

25. Më tej, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

26. Gjykata i referohet edhe nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili përcakton:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor”.

27. Gjykata më tej merr parasysh paragrafin (1) (c) të rregullit 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesit.

28. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se vendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 7 qershor 2016.

29. Gjykata vëren se parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 9 shkurt 2017.

30. Prandaj, Gjykata konsideron se kërkesa është parashtruar më shumë se 3 (tre) muaj përtej afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe siç parashihet më tej me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës.

31. Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa nuk është parashtruar brenda afatit prej 4 (katër) muajsh nga data në të cilën vendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës.

32. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike duke siguruar, se rastet që ngrenë çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe se vendimet e mëparshme nuk janë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar (Shih rastin e GJEDNJ-së, *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 23274/04, Aktvendimi i 25 gushtit 2005, dhe *mutatis mutandis*, rasti i Gjykatës

Kushtetuese nr. KI140/13, parashtrues: *Ramadan Cakiqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 marsit 2014).

33. Përveç kësaj, Gjykata vëren se është detyrë e parashtruesve të kërkesës që të veprojnë me *"kujdesin e duhur (due diligence)"* për t'u siguruar se kërkesat e tyre për mbrojtje të të drejtave janë dorëzuar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KIo7/15, parashtrues *Shefki Zogiani*, Aktvendim për papranueshmëri, paragrafët 46-52, me referenca të mëtejshme).
34. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si e paafatshme, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (c) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 24 tetor 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arteta Rama-Hajrizi